




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS**  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

**BULETINI I KËSHILLIT  
PROKURORIAL TË  
KOSOVËS 2024**



*Prishtinë, 2024*

# AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicionin pasqyrohen aktivitetet e KPK-  
së për muajin shtator të vitit 2024)

## Kryesuesi Hajdaraj priti në takim lamtumirës Ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport

Prishtinë, 3 shtator 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, ka pritur në takim lamtumirës Ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport.

Me këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj, ka shprehur mirënjohjen e tij të thellë për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të Ambasadorit Davenport gjatë udhëheqjes së Misionit të OSBE-së në Kosovë, duke kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e sistemit prokurorial të vendit. “Z. Ambasador, uroj të keni suksese të reja në angazhimet tuaja në të ardhmen dhe jemi mirënjohës për punën dhe bashkëpunimin tuaj që patëm gjatë kësaj kohe”, nënvizoi Kryesuesi Hajdaraj në këtë takim lamtumirës.

Nga ana tjetër, edhe Ambasadori Davenport, ka shprehur vlerësimin e tij për bashkëpunimin e OSBE-së me sistemin prokurorial, me ç’rast ka falënderuar Kryesuesin Hajdaraj për mbështetjen e tij gjatë proceseve të punës së përbashkët.



## **Komunikatë për media e Këshillit Prokurorial të Kosovës për procesin e rekrutimit të 24 prokurorëve të rinj (4 vende janë të rezervuara për prokurorë nga radhët e minoritetit serb)**

Prishtinë, 10 shtator 2024 – Këshilli Prokurorial i Kosovës njofton opinionin publik se edhe në rastin aktual të zhvillimit të procesit të rekrutimit të 24 prokurorëve të rinj të shtetit (4 vende janë të rezervuara për prokurorët nga radhët e minoritetit serb, me ç'rast nuk ka aplikuar asnjë kandidatë), por edhe në të ardhmen dhe në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore do të udhëheqë dhe administrojë procedurat e rekrutimit të prokurorëve të shtetit, duke u bazuar në kritere të përcaktuara dhe në përputhje me procedurat e paanshme dhe meritokratike, sepse rruga e vetme është respektimi maksimal i transparencës publike, që determinon marrjen e vendimeve të duhura në sistemin prokurorial.



Këtë proces rekrutimi, për të cilin kanë reaguar disa organizata joqeveritare, KPK-ja bënë me dije se janë duke e monitoruar përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë në Kosovë, duke informuar opinionin publik se përfaqësuesit e shoqërisë civile, përfshirë organizatat joqeveritare që reagojnë për mospjesëmarrjen e tyre në monitorimin e procesit të intervistimit me gojë të 24 kandidatëve për prokurorë, IKD-ja, Lëvizja FOL dhe INPO, vazhdimisht janë njoftuar dhe ftuar për monitorimin e proceseve të rekrutimit të kandidatëve për prokurorë të shtetit, qoftë për monitorimin e testeve kualifikuese apo qoftë të testeve me shkrim.

Përveç të tjerave, ato janë njoftuar dhe ftuar edhe për monitorimin e shqyrtimit të kundërshtimeve të kandidatëve për prokurorë të shtetit ose për procese të tjera, siç janë rastet e zgjedhjes së kandidatëve për kryeprokurorë të prokurorive të vendit.

Duke ditur se njoftimet dhe ftesat janë publikuar për përfaqësuesit e shoqërisë civile, këtu rezulton dhe del në pah moszbatimi sistematik i transparencës publike të këtyre organizatave lidhur me monitorimin e këtyre proceseve, sepse faktikisht nuk kuptohet se cila është logjika monitoruese e këtyre organizatave, ngaqë në dy proceset e kaluara ishin të ftuara dhe nuk morën pjesë fare, kur dihet që procesi i testimit kualifikues, i testimit me shkrim dhe intervistimit me gojë të kandidatëve janë të ndërlidhur pashmangshëm njëri me tjetrën.



Sa për dijeninë e publikut, njoftimet dhe ftesat e publikuara paraprakisht për këto organizata që nuk morën pjesë në monitorim janë të datave 19 maj 2024 (Testi Kualifikues) dhe 9 qershor 2024 (Testi me Shkrim).

Kurse, Komisioni për Rekrutim të Prokurorëve, dje, përmes zyrtarëve përgjegjës të KPK-së, ka kërkuar nga përfaqësuesit e organizatave në fjalë që ta lëshojnë hapësirën ku do të mbaheshin intervistat me gojë të prokurorëve të rinj, sepse nuk kanë qenë të ftuar me shkrim për monitorimin e procesit të intervistimit.

KPK-ja bënë me dije për opinionin publik se këto organizata, pra IKD-ja, Lëvizja FOL dhe INPO, nuk kanë marrë pjesë në asnjërën nga proceset e mëparshme të zhvilluara për rekrutimin e prokurorëve të shtetit, përveç atyre organizatave që kanë pasur memorandume bashkëpunimi me KPK-në.

Këshilli Prokurorial i Kosovës edhe njëherë përsëritë se ky proces është duke u monitoruar nga përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë.

## Mbahet takimi i parë i Grupit punues për hartimin e draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit

Prishtinë, 12 shtator 2024 - Grupi punues për hartimin e draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit, i kryesuar nga Zëvendëskryeprokurori në Prokurorinë Speciale, Valdet Gashi, mbajti takimin e parë të tij, pjesë të të cilit janë përveç përfaqësuesve të sistemit prokurorial edhe përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, Njësisë së Inteligjencës Financiare, Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe morën pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane dhe Ambasadës Britanike në Kosovë, të Zyrës së BE-së dhe EULEX-it.

Me këtë rast, kryesuesi i këtij grupi punues, Valdet Gashi, duke falënderuar të pranishmit, theksoi se qëllimi i takimit të sotë është diskutimi fillestar për hartimin e draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit, ekupe këto, që parashihet të veprojnë në kuadër të fushëveprimit të kompetencës së Prokurorisë Speciale, siç përcaktohet me ligj.

Më tej u zhvilluan diskutime me theks të veçantë në trajtimin e bazës së standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, në mënyrë që të krijohet ekipi i përbashkët hetimor ndërinstitucional, i cili ka për detyrë të arrijë objektivat e përbashkëta hetimore, si dhe ngritjen e bashkëpunimit të shumanshëm të PSRK-së, agjencive të tjera të zbatimit të ligjit dhe institucioneve publike, të cilat janë të obliguara të bashkëpunojnë me PSRK-në për hetimin e veprave të ndryshme penale në kompetencë të kësaj prokurorie.





## Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 17 shtator 2024 – Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i udhëhequr nga z. Jetish Maloku, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë edhe anëtarët e Grupit punues për monitorimin e zbatimit të SMIL-it, përfaqësuesja e CEPEJ-it, zyrtarë të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë dhe Departamentit të Teknologjisë Informative të SKPK-së.

Me këtë rast janë prezantuar të dhënat e pyetësorit lidhur me përshtypjet e stafit rreth përdorimit të SMIL-it dhe lehtësimit të punës, si dhe avancimit të tij sipas kërkesave të stafit të prokurorive të vendit, që janë mbajtur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Anëtarët e Komisionit dhe grupit punues, gjithashtu, trajtuan edhe sfidat e identifikuar gjatë shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet prokurorive dhe policisë dhe diskutuan për definimin e raporteve të reja statistikore, që paraqesin punën e prokurorive.



## Mbahet takim për hartimin e draftit të Planit strategjik dhe Planit të veprimit të sistemit prokurorial 2025-2027

Prishtinë, 19 shtator 2024 – Në kuadër të hartimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027, sot është mbajtur takimi i parë dyditor i Grupit punues për hartimin e këtij plani, i kryesuar nga Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Jehona Grantolli, me mbështetje të OSBE-së. Në këtë takim janë duke marrë pjesë Kryesuesi i KPK-së, z. Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, anëtarë të KPK-së, kryeprokurorë, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Drejtori i SKPK-së dhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane dhe Zyrës së BE-së.



Fillimisht, gjatë zhvillimit të sesionit të parë të këtij takimi, u prezantua raporti për zbatimin e Planit Strategjik 2024-2026, me ç' rast u nënvizuan të arriturat dhe sfidat e kësaj periudhe.

Përgjatë takimit, anëtarët e Grupit punues analizuan gjendjen aktuale të sistemit prokurorial krahas shtyllave dhe objektivave të planit paraprak, si dhe bazuar në këto diskutime është trajtuar metodologjia e punës, e cila do të përdoret për hartimin e këtij plani.

Ndër të tjera, udhëheqësja e Grupit punues, Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj. Jehona Grantolli, theksoi rëndësinë e planifikimit strategjik, si udhërrëfyes dhe themel i qëndrueshëm për arritjen e objektivave të sistemit prokurorial dhe përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor. “Një nga hapat kyç do të jetë identifikimi i fushave prioritare ku mund të përmirësojmë shërbimet tona, të rrisim profesionalizmin dhe të garantojmë një sistem prokurorial të pavarur dhe të drejtë”, tha zonja Grantolli.



Gjatë diskutimeve u theksua nevoja e trajtimit të duhur të objektivave të këtij plani, përfshirë avancimin dhe përmirësimin e procedurave dhe proceseve për të siguruar që çështjet të trajtohen shpejt dhe me cilësi, forcimi i mekanizmave të transparencës për të rritur besimin e publikut në sistemin prokurorial, ofrimi i trajnimeve specifike për prokurorët për të përmirësuar kapacitetet profesionale, nxitja e bashkëpunimit me institucionet e tjera për të adresuar çështje komplekse dhe për të përmirësuar koordinimin me partnerët ndërkombëtarë, rritja e kapaciteteve për të identifikuar dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe përdorimi i teknologjisë për të përmirësuar menaxhimin e informacionit dhe efikasitetin në punë dhe çështje të tjera. Takimi ka vazhduar edhe gjatë ditës së nesërme.



## Kryesuesi Hajdaraj priti në takim një ekip vlerësues të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS)

Prishtinë, 24 shtator 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj, i shoqëruar nga Drejtori i Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi, priti në një takim përfaqësuesit e ekipit të pavarur vlerësues të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS), i cili është duke qëndruar në Kosovë në kuadër të vlerësimit të ndikimit të EULEX-it në Kosovë gjatë periudhës 2018-2024.



Fillimisht, Kryesuesi Hajdaraj, ka njoftuar përfaqësuesit e këtij ekipi për aktivitetet e përbashkëta dhe bashkëpunimin e zhvilluar në partneritet me mekanizmat e EULEX-it, duke falënderuar njëkohësisht EULEX-in për ofrimin e ndihmës konkrete dhe mbështetjes së vazhdueshme në proceset e përgjithshme të fuqizimit dhe avancimit të sundimit të ligjit në Kosovë. “Arritjet e përbashkëta janë të rëndësishme dhe janë shënuar falë një përkushtimi të madh të këtij misioni me KPK-në dhe përgjithësisht me sistemin prokurorial, duke ndihmuar përgjatë proceseve vendimtare që kemi në rrugën përpara”, tha Kryesuesi Hajdaraj më këtë rast.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e ekipit vlerësues, informuan z.Hajdaraj se vlerësimi i paraparë është pjesë e një procesi, përmes të cilit, shtetet anëtare të BE-së janë pajtuar të vlerësojnë ndikimin e misioneve të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes evropiane, përfshirë edhe ndikimin e misionit të EULEX-it në Kosovë.



Bashkëbiseduesit diskutuan më tej dhe shkëmbyen informacione për përcaktimin e rezultateve të EULEX-it dhe perceptimin e të arriturave, përfundimin e projekteve aktuale dhe ndikimin e aktiviteteve të ardhshme në sistemin prokurorial të Kosovës.



## Mbahet Takimi i 253-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 24 shtator 2024 - Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 253-të me radhë, në të cilin diskutoi pikat e parapara në rendin e ditës.



Të gjitha vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç' rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:

- Miratoi Rregulloren për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës;
- Miratoi Raportin tremujor për aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik për periudhën prill-qershor 2024;
- Miratoi Raportin gjashtëmujor për zbatimin e Planit të veprimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial për periudhën janar-qershor 2024;
- Caktoi prokuroren në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula, në detyrën e anëtares së Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe

- Autorizoi Komisionin për Çështje Normative për plotësimin e Rregullore 02/2024 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës, me një paragraf shtesë që ka të bëjë me sistematizimin e zyrtarëve sipas kësaj rregulloreje.





## Shënohet Java e Qasjes në Dokumente Publike

Prishtinë, 25 shtator 2024 – Në kuadër të shënimit të Javës së Qasjes në Dokumente Publike, anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) nga radhët e shoqërisë civile, z. Visar Krasniqi, sot ishte pjesë e një paneli të diskutimit për zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, i ftuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP). Në këtë panel morën pjesë përfaqësues të gjykatave, agjencive të pavarura, mediave dhe të shoqërisë civile.



Z. Krasniqi, gjatë fjalës së tij, potencoi rëndësinë e qasjes në dokumente publike, e cila është inkorporuar në të drejtën e lirisë së shprehjes, ngaqë qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile iu mundësohet qasja dhe pjesëmarrja efektive në jetën publike dhe në çështjet që kanë të bëjnë me jetët e tyre dhe të shoqërisë përgjithësisht. “Sistemi prokurorial tashmë ka një kuadër ligjor të përcaktuar mirë të qasjes në dokumente publike, siç është edhe Rregullorja për Qasje në Dokumente Publike e Sistemit Prokurorial, e cila qartëson mënyrën se si mund të ketë gjithnjë e më shumë transparencë publike”, tha më këtë rast z.Krasniqi.

Gjithashtu, z.Krasniqi, shpjegoi para të pranishmeve se, sipas raporteve për qasje në dokumente publike, rezulton se fryma e kërkesave për qasje në dokumente publike të sistemit prokurorial ishte e natyrës financiare dhe e shpenzimit të parasë publike, por ka edhe të natyrave të tjera, si dhe zyrtarët angazhohen që të mos cenohet ndjeshmëria e rasteve dhe të mbrohen të dhënat personale, çështje këto, që



hyjnë në kuadër të aspekteve thelbësore për forcimin e transparencës dhe ngritjes së llogaridhënies institucionale.

Në panelin e diskutimeve është theksuar nga z.Krasniqi si një e arritur edhe publikimi i vendimeve disiplinore dhe i të dhënave që kanë të bëjnë me statistikat për nivelin e performancës së prokurorëve të shtetit.





Në këtë tryezë u tha se nga matjet e bëra rezulton se 80% e kërkesave për qasje në institucionet publike ndërlidhen me dokumentet, të cilat, faktikisht, do të duhej të ishin të publikuara, sepse kjo rrjedhimisht do të rezultojë në një vendimmarrje më të mirë, do të rrisë komunikimin e qytetarëve dhe shoqërisë civile me organet publike dhe veçanërisht vë në pah integritetin institucional.

## Përfaqësuesit e sistemit prokurorial, pjesëmarrës në konferencën rajonale për ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor

Budvë, 27 shtator 2024 – Në kuadër të shkëmbimit të përvojave në mes të sistemeve rajonale të drejtësisë, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi dhe Zëvendëskryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Valdet Gashi, po marrin pjesë në Konferencën rajonale “Efektshmëria e gjyqësorit në gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”. Për të ndarë përvojat e tyre, kjo konferencë, që mbahet në Budvë të Mal të Zi, nën organizimin e OSBE-së, përveç përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë nga Kosova, ka bërë së bashku edhe përfaqësues nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Bashkimi Evropian.



Qëllimi i organizmit të kësaj konference, si pjesë e projektit rajonal të OSBE-së për monitorimin e proceseve gjyqësore në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor, është diskutimi për çështjet e përbashkëta të ndjekjes dhe gjykimin të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Më këtë rast, kreu i KPK-së, Hajdaraj, ka mirëpritur organizimin e këtij evenimenti rajonal, duke theksuar se gjithnjë janë të nevojshme diskutimet që ndërlidhen me promovimin e transparencës dhe llogaridhënies publike, si dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm në zbatimin e reformave në sistemin e drejtësisë.





Përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë nga rajoni, gjatë diskutimeve nëpër sesione të ndryshme, nënvizuan se synim i gjithanshëm i tyre është mbështetja e administrimit efektiv të drejtësisë në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke rritur njohuritë e bazuara në prova dhe të kuptuarit e përgjigjeve gjyqësore në këto raste.

Gjatë sesioneve të sotme të kësaj konference do të prezantohet raporti i OSBE-së me gjetjet nga monitorimi trevjeçar i sistemeve gjyqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor.

